

BULETINI



KOMUNA E LIPJANIT
SHKURT 2026

NDEROHET ME HOMAZHE DËSHMORI XHEVDET BREZNICA

Me rastin e përvjetorit të rënies së dëshmorit Xhevdet Breznica, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët, bëri homazhe dhe vendosi buqeta me lule pranë lapidarit në fshatin Dobrajë e Madhe, si shenjë respekti dhe mirënjohjeje për veprën e pavdekshme.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti theksoi se respekti dhe mirënjohja ndaj dëshmorëve duhet të jenë të përhershme, sepse mbi veprën e tyre është ndërtuar liria dhe perspektiva e vendit tonë. Sakrifica sublime e tyre na obligon që me përgjegjësi dhe përkushtim të vazhdueshëm, të punojmë çdo ditë për një Kosovë më të fortë dhe më të begatë.

Lavdi të gjithë dëshmorëve!



KPF MBAN MBLEDHJEN E DYTË ME RADHË

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e dytë me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje. Gjatë këtij takimi, Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, përveç pikave të propozuara, ka prezantuar edhe dy pika shtesë për diskutim.

Pas diskutimeve, anëtarët e KPF-së kanë rekomanduar të gjitha pikat për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të enjten, më 12 shkurt 2026.



U MBAJT MBLEDHJA E 4-TË ME RADHË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, i udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 4-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës, të cilat ishin propozuar për këtë seancë.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Gjatë punimeve të kësaj seance u miratuan këto pika të rendit të ditës



KOMITETI PËR KOMUNITETE MBAJTI MBLEDHJEN E PARË

Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Në këtë takim, anëtarët e Komitetit zgjodhën z. Alush Bikliqin, kryesues të Komitetit për Komunitete me të gjitha votat.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët u njoftuan gjithashtu me procedurat dhe kompetencat e Komitetit për Komunitete, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.



NXËNËSIT E KLASAVE TË PARA TË SHFMU “VËLLEZËRIT FRASHËRI” VIZITUAN KUVENDIN E KOMUNËS SË LIPJANIT PËR 18-VJETORIN E PAVARËSISË SË KOSOVËS

Në kuadër të shënimit të 18-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, nxënësit e klasave të para të Shkollës Fillore “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan zhvilluan një vizitë edukative në Kuvendin e Komunës së Lipjanit. Qëllimi i aktivitetit ishte t’u prezantohej fëmijëve funksionimi i institucioneve vendore dhe roli i tyre institucional. Drejtori i Arsimit, z. Rasim Hasani, fillimisht iu uroi nxënësve dhe stafit të shkollës 18-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Në vazhdim ai falënderoi stafin për angazhimin dhe përkushtimin në edukimin e brezave të rinj, duke shprehur mirënjohjen edhe për organizimin e vizitës. Gjatë vizitës nxënësit patën mundësinë të njihen nga afër me punën e Kuvendit dhe të Komunës, duke mësuar për proceset institucionale dhe rëndësinë e qytetarisë aktive.



KRYETARI AHMETI BËN HOMAZHE NË NDER TË DITËS SË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët, me rastin e 18 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, bëri homazhe dhe vendosi një buqetë me lule pranë lapidarit të Komandantit Legjendar, Adem Jashari.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se 17 shkurti shënon një nga momentet më të rëndësishme në historinë e Republikës së Kosovës. Kjo datë nuk është vetëm festë, por edhe ditë kujtese dhe nderimi për sakrificat e brezave që luftuan dhe kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit.



ME AKTIVITETE FESTIVE SHËNOHET 18 VJETORI I PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 18 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, dhe të organizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, u krijua një atmosferë festive për të gjithë qytetarët e pranishëm.

Programi përfshiu koncert muzikor me interpretimin e artistëve të njohur si DJ Ami, Alban Mehmeti, Flamur & Ilir, Saranda Korpuzi, Bardha Drnogllava dhe Emir Drnogllava, të cilët me performancën e tyre sollën energji të jashtëzakonshme, duke e shndërruar këtë ditë në një festë të paharrueshme. Për më të vegjlit u organizuan aktivitete rekreative dhe zbavitëse, ndërsa në përmbyllje u shpërndanë dhurata simbolike në nder të kësaj dite të rëndësishme për vendin tonë.

Gëzuar Ditën e Pavarësisë së Kosovës!



KRYETARI AHMETI VIZITON SHOQATËN HUMANITARE “BEREQETI”

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me nënkryetarin z. Diamant Bytyqi, vizituan Shoqatën Humanitare “Bereqeti”, ku u pritën nga drejtori i shoqatës, z. Xheladin Fazliu, i cili i njoftoi nga afër me aktivitetet dhe projektet e realizuara në shërbim të qytetarëve.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti falënderoi përfaqësuesit e shoqatës për pritjen dhe angazhimin e vazhdueshëm në mbështetje të familjeve në nevojë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave humanitare.

“Kontributi juaj është një ndihmë e madhe jo vetëm për qytetarët, por edhe për institucionet dhe vetë shtetin. Ju lehtësoni një pjesë të barrës përmes projekteve që synojnë mbështetjen e familjeve në nevojë. Organizata si kjo janë tejet të rëndësishme, pasi ndihmojnë në adresimin e shumë çështjeve që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve”, tha kryetari, z. Imri Ahmeti.

Ndërsa drejtori i Shoqatës Humanitare “Bereqeti”, z. Xheladin Fazliu, falënderoi kryetarin Ahmeti për vizitën dhe për mbështetjen e vazhdueshme të Komunës së Lipjanit në realizimin e aktiviteteve dhe projekteve humanitare në Lipjan. Në fund të vizitës kryetari Ahmeti, iu nda një mirënjohje në shenjë respekti për bashkëpunimin.



KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT, Z. IMRI AHMETI, KA NËNSHKRUAR MEMORANDUM TË MIRËKUPTIMIT ME ZNJ. HANA ZYLFIU HAZIRI DHE Z.BEKIM KRASNIQI PËRFAQËSUES TË ORGANIZATAVE QENDRA PËR ARSIM E KOSOVËS (KEC) DHE ASOCIACIONI RINOR PËR TË DREJTAT E NJERIUT, ME QËLLIM TË MBËSHTETJES DHE FUQIZIMIT E TË RINJËVË LIPJANAS NË FUSHËN DIGJITALE.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti theksoi se kjo marrëveshje është dëshmi e përkushtimit tonë institucional për t'u krijuar të rinjve hapësira të reja për zhvillim dhe për të investuar në të ardhmen e tyre, përmes aktiviteteve inovative, edukative dhe teknologjike.

Nga ana tjetër përfaqësuesit e OJQ-ve në fjalë theksuan se ky bashkëpunim forcon partneritetin ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe OJQ-ve palë nënshkruese të këtij bashkëpunimi për realizimin e projekteve të përbashkëta që adresojnë nevojat dhe potencialin e të rinjve të Komunës së Lipjanit



DREJTORI I DKA-SË PRET NË TAKIM NXËNËSIT FITUES TË SHKOLLAVE “VËLLEZËRIT FRASHËRI” DHE “EMIN DURAKU”

Drejtori i Arsimit në Komunën e Lipjanit, z. Rasim Hasani, ka pritur në takim nxënësit e shkollave fillore “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan dhe “Emin Duraku” në Banullë, së bashku me drejtorët e shkollave z. Jakup Bahtiri dhe z. Raif Sadiku, si dhe stafin arsimor pas suksesit të arritur në garat e ASEF-it në Tiranë. Gjatë takimit drejtori z. Hasani, i përgëzoi nxënësit për përfaqësimin dhe suksesin e arritur, duke theksuar se këto rezultate janë dëshmi e cilësisë së punës në shkollat e komunës sonë.

“Ky sukses dhe numri i madh i nxënësve tanë që marrin pjesë në gara të ndryshme dhe arrijnë rezultate të jashtëzakonshme na bën të ndihemi krenarë, jo vetëm si institucion por edhe si qytetarë të Komunës së Lipjanit. Kjo dëshmon se shkollat tona janë në një nivel profesional në përgatitjen e kuadrove të reja të cilat janë e ardhmja e vendit tonë”, tha drejtori i DKA-së, z. Rasim Hasani.

Ndërsa drejtori i shkollës “Vëllezërit Frashëri”, z. Jakup Bahtiri, në emër të nxënësve dhe stafit, falënderoi Komunën e Lipjanit për mbështetjen e vazhdueshme që ka mundësuar pjesëmarrjen në gara si ASEF, duke theksuar se ky bashkëpunim e motivon shkollën të vazhdojë me përkushtim dhe ta përfaqësojë denjësisht komunën brenda dhe jashtë vendit.



KRYETARI AHMETI NËNSHKRUAN MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR FUQIZIMIN E GRAVE SIPËRMARRËSE

Kryetari Ahmeti nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi për fuqizimin e grave sipërmarrëse

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim Drejtorin e organizatës PREDA Plus, z. Valentin Hoxha, me të cilin ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi në kuadër të projektit “E Ardhmja e Saj - Fuqizimi i Grave Sipërmarrëse në Kosovë”, me qëllim mbështetjen dhe avancimin e rolit të grave në zhvillimin ekonomik lokal.

Me këtë rast Kryetari Ahmeti, theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi për rritjen e përfshirjes së grave në fushën e ndërmarrësisë dhe fuqizimin e tyre ekonomik.

“Mbështes fuqishëm iniciativa që synojnë fuqizimin ekonomik të grave pasi konsideroj se përfshirja e tyre aktive në biznes dhe ndërmarrësi është një faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, mbështetja e grave në biznes jo vetëm që rrit pavarësinë e tyre ekonomike por kontribuon drejtpërdrejt edhe në mirëqenien e familjeve dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të shoqërisë”, tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Ky bashkëpunim synon krijimin e mundësive të reja ekonomike për gratë dhe vajzat rritjen e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës, si dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në nivel lokal.

Projekti financohet nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim-BMZ dhe zbatohet nga PREDA Plus në partneritet me WEntrepreneur, me mbështetjen e organizatës Arbeiter Samariter Bund-ASB Köln.



KRYETARI AHMETI PRET NË TAKIM KRYETARIN E SHOQATËS SHQIPTARE “KOSOVA RUMELI” NË BUCA TË TURQISË

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim kryetarin e Shoqatës Shqiptare “Kosova Rumeli” në Buca të Turqisë, z. Uğur Şengöz, me të cilin diskutoi për mundësitë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale dhe diasporës shqiptare në Turqi.

Me këtë rast kryetari Ahmeti, falënderoi përfaqësuesit e shoqatës për vizitën, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes dhe zhvillimit të lidhjeve të vazhdueshme me diasporën shqiptare.

“Diaspora shqiptare në Turqi ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në forcimin e lidhjeve ndërmjet institucioneve dhe bashkatdhetarëve tanë, ne mbetemi të përkushtuar që këtë bashkëpunim ta zgjerojmë edhe më tej në fusha me interes të përbashkët, veçanërisht në kulturë, arsim dhe zhvillim ekonomik”, tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Gjatë takimit palët theksuan rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet komunitetit shqiptar në Buca dhe vendlindjes, si dhe diskutuan mundësitë për realizimin e projekteve të përbashkëta që synojnë promovimin e vlerave kulturore dhe forcimin e lidhjeve institucionale.

Ndërsa kryetari i shoqatës, z. Uğur Şengöz, falënderoi kryetarin Ahmeti për mikpritjen dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke vlerësuar angazhimin e Komunës së Lipjanit në ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve me diasporën shqiptare në Turqi, si dhe duke shprehur interesimin për zgjerimin e bashkëpunimit në aktivitete kulturore.





Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508